



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Nr. 02/1030

Datë: 05/09/2025

Duke u bazuar nën 13 dhe 58 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr-03/L-040, në bazë të nenit 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 dhe nenit 25 paragrafi 5 të Ligjit Nr-08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sipas kërkesës së nëpunësit z.Armend Imeri Nr.23520/25, datë 04.09.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

AKTVENDIM

(Për pezullim të përkohshëm të pozitës)

- I- Nëpunësi z. Armend Imeri i sistemuar me detyra të punës Koordinator i puneve teknike në kuadër të Drejtorise për Administratë të Përgjithshme i lejohej pezullimi i përkohshëm i të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënie e punës (pa pagesë) për shkak të kandidatimit për Asamble Komunale në zgjedhjet e vitit 2025.
- II- Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës fillon shtatë (7) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon pesë (5) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës, konkretisht nga data: 05.09.2025 e deri me datë: 17.10.2025.
- III- I lartëpërmenduri e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme.
- IV- Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset NJMBNJ.

ARSYETIM

z. Armend Imeri i sistemuar me detyra të punës Koordinator i puneve teknike në kuadër të Drejtorise për Administratë të Përgjithshme ka bërë kërkesë Nr.23520/25, datë 04.09.2025, me të cilën ka kërkuar që të lirohet nga puna pasi që është kandiduar për Asamble Komunale për zgjedhjet e vitit 2025.

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit që gjendet në lëndë, konstaton dhe vendosi që të ja lejojë pezullimin e përkohshëm të pozitës, duke filluar nga data 05.09.2025 e deri me datë: 17.10.2025, duke u bazuar dispozitat të Ligjit Nr-08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të Rregullores (QRK) Nr.28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës.

Këshillë juridike: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh në Komisionin e ankesave.

Aktvendimi i dorëzohet:

Nëpunësi / ja- Armend Imeri

Zyra e Kryetarit

NJMBNJ



Kryetari i Komunës
Qemal Aliu